

Përfshirja përpjesëtimore e fjalëve emërtuese në FGJSSH

Mr. Agim Spahiu

16 janar 2008

Përmbledhje

Gjuhësia shqiptare deri më sot ka shënuar arritje të konsiderueshme në shumë fusha të saj. Madje në këtë aspekt, ajo mund të barazohet edhe me disa qendra studimore më me traditë në rajon e më gjerë. Por ne nuk duhet të jemi asnjëherë të kënaqur e të mjaftuar me këto rezultate të arritura. Përkundrazi duhet të synohet gjithnjë për arritje akoma më të madha, sidomos në ato disiplina gjuhësore të konsoliduara tashmë shumë vonë edhe në Evropë e më gjerë, siç është bie fjala gjuhësia matematikore a statistikore, për vetë faktin se edhe ne si studiues e popull e kemi të njëjtën teknologji informative elektronike që e ka edhe bota e qytetëruar sot. Prandaj kërkohet vetëm punë.

Edhe nga vetë titulli shihet se ky shkrim ka të bëjë me çështje statistikore. Për objekt vështrimi kemi marrë fjalët emërtuese, siç janë: emrat, mbiemrat, foljet dhe ndajfoljet në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980). Me ndihmën e programeve: grep, sort, uniq, sed, awk etj. është arritur të sortohet pa asnjë përsëritje numri i saktë i fjalëve të përmendura nga Fjalori elektronik i gjuhës shqipe. Nga ky numër pastaj shumë lehtë e kemi përcaktuar edhe përqindjen e tërësishme të tyre në raport me numrin e përgjithshëm të fjalësit që përmban ky Fjalor.

Duke u bazuar në korpusin gjuhësor, të mbledhur në mënyrë elektronike nga Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980), me ndihmën e programeve standarde të UNIX-it/Linux-it, siç janë: grep, sort, uniq, sed, awk etj. është bërë një analizë statistikore e të dhënave të rëndësishme lidhur me përfshirjen e fjalëve emërtuese në FGJSSH.

Sikundër dihet, ky Fjalor është shpjegues dhe normativ. Është i tipit të mesëm dhe ka 41.066 fjalë.

Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, që nga botimi i tij e deri më sot, më sa dimë ne, ka qenë objekt studimi nga ana e studiuesve tanë, por edhe të huaj. Ata i janë qasur këtij Fjalori nga shumë anë e aspekte, sidomos nga aspekti fjalëformues, por shumë pak nga aspekti i një analize të mirëfilltë statistikore- gjuhësore. Janë të pakët ata gjuhëtarë, mësues gjuhe, publicistë etj., të mos i jenë referuar këtij Fjalori të paktën një herë për të nxjerrë shpjegime a informacione për fjalë a shprehje të caktuara. Por, po ta pyesësh ndonjërin prej tyre se sa fjalë emërtuese ka, po e zëmë, ky Fjalor, atëherë ka shumë të ngjarë të mbesim pa ndonjë përgjigje ose edhe nëse jepet ajo përgjithësisht do të jetë e

gabuar. Kjo ndodh kështu sepse ne ende nuk kemi të dhëna të përpikta statistikore për të gjitha kategoritë leksiko - gramatikore që janë përfshirë në këtë Fjalor.

Pra, mungesa e këtyre të dhënave të nevojshme qe edhe arsyeja që t' i qasemi kësaj pune dhe kemi arritur të japin një pasqyrë statistikore, të cilën po e prezantojmë këtu më poshtë:

Për analizë janë marrë vetëm fjalët emërtuese siç janë: emrat, mbiemrat, foljet dhe ndajfoljet. Të tjerat fjalë të pjesëve të ligjëratës nuk janë marrë në shqyrtim për vetë faktin se ato përbëjnë një numër shumë të vogël në krahasim me këto të përmendurat. Mirëpo, numri i fjalëve joemërtuese mund të dihet përafërsisht edhe pasi të jepen të dhëna statistikore për fjalët emërtuese të cilat përbëjnë *korpusin* themelor të këtij Fjalori.

Me anë të këtij programi është arritur ky rezultat, në sa vijon: Fjalori ka përgjithësisht 21.281 emra, prej të cilëve të gjinisë mashkullore janë: 10.341 ose 48,6 përqind, të gjinisë femërore janë: 10.852 emra ose 51 përqind dhe të gjinisë asnjëse vetëm 88 emra ose përafërsisht 0.41 përqind. Kjo pjesë e ligjëratës në FGJSSH është përfshirë me 51. 8 përqind, në raport me numrin e gjithëmbarshtëm të fjalëve që përmban ky Fjalor.

Nga sistemi foljor kemi gjithsej: 6873 folje. Prej tyre janë: 3244 folje kalimtare ose 47,2 përqind, jokalimtare 726 ose 10,6 përqind, vetvetore 2427 ose 35,3 përqind, pësore 582 ose 8,5 përqind dhe pësore-vetvetore vetëm 39 sosh ose përafërsisht 0,56 përqind. Pra, nga kjo del se folje ka shumë më pak ose 16,7 përqind nga fjalësi që ka ky Fjalor ose dy herë e më pak se emra.

Nga sistemi mbiemëror janë numëruar 9684 mbiemra. Në këtë numër janë përfshirë të gjithë mbiemrat, qoftë të nyjshëm apo të panyjshëm. Po të shprehemi në përqindje me numrin e përgjithshëm të fjalëve del se në Fjalor janë të evidentuar 23,6 përqind mbiemra. Pra, diku më pak se gjysma e emrave ose diçka më shumë se numri foljeve.

Ndërsa sa u përket ndajfoljeve në Fjalor janë gjithsej 1684 ndajfolje te të gjitha llojeve. Kjo do të thotë se ato zënë vend vetëm me 4,1 përqind të tërë materialit gjuhësor.

Prandaj, po të merret parasysh numri i sakët i fjalëve emërtuese, të shprehura në përqindje del se FGJSSH-i ka 39.522 fjalë emërtuese që përbën 96,25 përqind të fjalësit të përgjithshëm.

Në anën tjetër, meqë FGJSSH ka 41.066 fjalë, atëherë del se 1.544 fjalë e fjalëza të tjera janë joemërtuese, treguese a shërbyese, siç janë: përemrat, numërorët, parafjalët, lidhëzat, pasthirrmat etj. ose më pak se 4 përqind.

Këto janë vetëm disa të dhëna të sakta statistikore të paraqitura shkurtimisht në këtë shkrim përmbledhës, por kjo nuk do të thotë se gjuha shqipe ka përfundimisht kaq fjalë emërtuese. Gjuha e sotme shqipe sot pas 27 vitesh të botimit të këtij Fjalori ka sigurisht një fizionomi tjetër, kuptohet ka evoluar me një thesar më të pasur e më të gjerë jo vetëm me fjalë emërtuese. Si dëshmi e një begatie të saj është edhe FGJSSH-i i vitit 2002, të cilin po ashtu do ta shqyrtojmë më vonë nga ky aspekt.




Figura 1: Përqindja e fjalëve emërtuese të përfshira në FGJSSH